

**UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT
VENDIM**

Nr. 10, datë 15 /04 /2019

MBI

**“MIRATIMIN PARAPRAK, PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
PERKUSION, CIKLI I PARË BACHELOR, NË FAKULTETIN E MUZIKËS TË
UNIVERSITETIT TË ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 13, datë 09.04.2019 “Mbi Miratimin paraparak, për hapjen e programit të studimit Perkusion, në Fakultetin e Muzikës të Universitetit të Arteve”; Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 31, datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë” dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Fakulteti i Muzikës, pasi e diskutoi me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin paraparak, për hapjen e programit të studimit Perkusion, në Fakultetin e Muzikës të Universitetit të Arteve, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit së Arsimit Sportit dhe Rinisë për miratim përfundimtar.
3. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Besnik BISHA (Kryetar)

Risena XHAJA (Anëtar)

UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Prof. Arben BASHA (Anëtar)

Aida MARTIRO (Anëtar)

Prof. Artan PEQINI (Anëtar)

Prof. Bujar KAPEXHIU (Anëtar)

Lorenc VANGJELI (Anëtar)

